

VENDIM
Nr. 793, datë 9.11.2016

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË SPECIALIZANTËVE QË KANË
LIDHUR KONTRATË ME MINISTRINË E DREJTËSISË, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË
VENDIMIT NR. 763, DATË 12.11.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E
SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE NË FUSHËN
E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2014–2015”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për kuotat e mbuluara, të parashikuara në pikën 13, të vendimit nr. 763, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2014–2015”, studentët, të cilët kryejnë specializimin dhe që kanë lidhur kontratë me Ministrinë e Drejtësisë, paguhet në masën 80 për qind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.

2. Shpenzimet për këta specializantë përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2017.

3. Për likuidimin e detyrimeve të mbartura të specializantëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, për vitet 2015 dhe 2016, bëhet shtesë fondi në programin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në masën 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë, dhe në programin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, në masën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë.

4. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 763, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi